



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje artikuj kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (CPV): 22816100-4 Bllok shënimesh, (CPV): 30192121-5 Stilolapsa me majë të rrumbullakët, (CPV): 30192122-2 Stilografë ,(CPV): 30192130-1 Lapsa, (CPV): 30192160-0 Korrektues, (CPV): 30199230-2 Zarfa, (CPV): 39241200-5 Gërshërë.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,517,358.56 (një milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë e pesëdhjetë e gjashtë të qindat) lekë pa Tvsh, nga të Ardhurat për Bashkinë Divjakë.

Burimi i financimit: Të Ardhurat për Bashkinë Divjakë.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Divjakë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vjetët e fundit financiarë 2023, 2024 dhe 2025 nga operatori ekonomik, ku vlera e xhiros në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, specifikisht “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, ku pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në pikën 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bere që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin

publik” i ndryshuar, ne nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, per te permbushur me sukses kontraten. Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/c, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”.

“Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 dhe te nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) vjetëve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetem fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40, pika 4 dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën e cilësisë SSH/EN/ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

(Çertifikata si më sipër, duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e*

cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit,, si edhe ne Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer shërbimin objekt kontrate. Ne lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standartit si SSH/EN/ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i SSH/EN/ISO rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në ambjentet e AK, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhenia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mallrat e ofertuar janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Autoriteti/Enti Kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Vendosija e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se Operatori Ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë, të vërtetojnë dhe garantojnë AK, se të gjitha mallrat e ofertuara, janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e procedurës janë hartuar në përputhje me natyrën, funksionin dhe përdorimin e mallrave objekt prokurimi, me qëllim garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre për nevojat e institucionit. Këto specifikime nuk kanë për qëllim kufizimin e konkurrencës, por sigurimin që mallrat e ofruara të përmbushin standardet e kërkuara për përdorim administrativ.

Specifikimet teknike për pjesën më të madhe të artikujve objekt prokurimi, janë hartuar duke u bazuar në Katalogun “Blerje Materiale Kancelarie”, datë 23.10.2025, të publikuar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Ndërsa për disa artikuj të veçantë, konkretisht zërat (Nr. 21, 51, 52, 58, 60, 92-95, 97, 105, 106, 119-121, 124, 126, 128-131, 133, 135 dhe 136), të cilët nuk ishin të përfshirë në këtë katalog, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar specifikime teknike në mënyrë të pavarur, bazuar në nevojat konkrete, funksionale dhe operative të institucionit, duke respektuar natyrën dhe qëllimin e përdorimit të tyre.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr.	Emërtimi	Njësia	Specifikime
1	Letër Format A4 80 GSM (210 X 297 MM)	risma 500 fletë	Përmasa A4 (210mm x 297mm); -Lëmueshmëria 100-150ml/min sipas ISO 8791-2; -Lagështia 3-4% sipas ISO 287; -Trashësia 109-115 µm sipas ISO 534; -Dukshmëria (Opacity) >94% sipas ISO 2471; -Shkëlqimi 106-115% sipas ISO 2470-2; -CIE Bardhësia 158-175 sipas ISO 11475. -Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706
2	Letër fotokopje A3	risma 500 fletë	Përmasa A3 (420mm x 297 mm); -Lëmueshmëria: 80-130 ml/min sipas ISO 8791-2; -Lagështia: 3.5-4.5% sipas ISO 287;

			-Trashësia: 103-115 µm sipas ISO 534; -Shkëlqimi: 101-115% sipas ISO 2470-2; -Dukshmëria >94% sipas ISO 2471; -CIE bardhësia: 148-170 sipas ISO 11475; -Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706
3	Dosje kartoni e thjeshtë	copë	Të jetë material kartoni, përmasa 25 x 34 cm, me veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) 9 cm. (deri ne 5% marzh gabimi).
4	Dosje personeli	copë	Dosje personeli, materiali PVC, ngjyra të ndryshme, me kapse metalike të brendshme, përmasat e dosjes 32 x 24 x 2 cm (marzh gabimi deri në 5%). Në pamjen ballore (kapakun e dosjes) të jetë e stampuar: Stema e Republikës së Shqipërisë, emri i institucionit përkatës sipas kërkesës, me madhësi shkrimi 12 dhe gërma kapitale. Në qendër të dosjes të shkruhet: Dosje Personeli (me madhësi shkrimi 14 dhe gërma kapitale). Në pjesën e poshtme të shkruhet nr. dosjes dhe në fund Emër, Atësia, Mbiemër. Dosja të mbyllet me dy llastiqe anësore në krahun e djathtë të saj. Në krahun e majtë të dosjes në pjesën e brendshme, të ketë 2 xhepa të brendshëm për fotografi të përmasave 9 x 12 cm dhe 4 x 6 cm. Në krahun e djathtë të dosjes, në pjesën e brendshme të ketë xhep me përmasat 30 x 15 cm, (marzh gabimi deri në 5%).
5	Dosje arkive me lidhëse 15 cm	copë	Të jetë karton i trashë, me gjerësi 15 cm, të ketë hapësirë për të ruajtur sa më shumë vëllim të jetë e mundur, me ngjyra të ndryshme.
6	Dosje arkive kartoni me buton 6 cm	copë	Të jetë material kartoni, të ketë kapëse (perçinë) për mbylljen e dosjes, në brendësi të ketë kapak fiksues me perçina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore, të jetë me përmasa 35 x 24.5 x 6 cm (deri në 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme.
7	Dosje arkive kartoni me buton 10 cm	copë	Të jetë material kartoni, të ketë kapëse (perçinë) për mbylljen e dosjes, në brendësi të ketë kapak fiksues me perçina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore, të jetë me përmasa 34 x 24 x 10 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme.
8	Dosje arkive kartoni me buton 12 cm	copë	Të jetë material kartoni, të ketë kapëse (perçinë) për mbylljen e dosjes, në brendësi të jetë me veshë në anësore për mbajtjen e dokumentave. Përmasa 24.5 x 35 x 12 cm (marzh gabimi deri në 5%).
9	Dosje arkive kartoni buton 15 cm	copë	Të jetë material kartoni, të ketë kapëse (perçinë) për mbylljen e dosjes, në brendësi të ketë kapak fiksues me perçina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore, të jetë me përmasa 34 x 24 x 15 cm (marzh gabimi deri në 5%), me ngjyra të ndryshme.
10	Dosje kartoni me llastik	copë	Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, të ketë nga brenda veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave). Të mbyllet me llastik. Përmasat 24 x 34 cm (marzh gabimi deri në 5%).

11	Dosje kartoni me llastik 2 cm	copë	Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, të jetë me llastik për mbyllje, të ketë nga brenda veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) Përmasa 25 x 34.5 x 2 cm (marzh gabimi deri në 5%).
12	Dosje kartoni me llastik 3 cm	copë	Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, të jetë me llastik të trashë për mbyllje, të ketë nga brenda veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) Përmasa 25 x 34.5 x 3 cm (marzh gabimi deri në 5%).
13	Dosje kartoni me llastik 5 cm	copë	Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, me llastik. Të jetë nga brenda me veshë në anësore, 2 copë lart/poshtë për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) për fiksimin e materialeve. Përmasa e dosjes 25 x 34.5 x 5 cm (marzh gabimi deri në 5%).
14	Dosje kartoni me llastik 10 cm	copë	Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, me llastik. Të jetë nga brenda me veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) për fiksimin e materialeve. Përmasa 25 x 34.5 x 10 cm (marzh gabimi deri në 5%).
15	Dosje me 30 zarfa plastik	copë	Të jetë me 30 zarfa plastike për mbajtje dokumentash në format A4. Zarfat plastike duhet të jenë të integruar në 30 ndarje në pjesën e brendshme. Zarfat të jenë të tejdukshëm që të mundësojnë lexueshmëri të dokumentave. Trashësia e zarfit të brendshem 35-40 mic.
16	Dosje me 50 zarfa plastik	copë	Të jetë me 50 zarfa plastike për mbajtje dokumentash në format A4. Zarfat plastike duhet të jenë të integruar në 50 ndarje në pjesën e brendshme. Zarfat të jenë të tejdukshëm që të mundësojnë lexueshmëri të dokumentave. Trashësia e zarfit të brendshem 35-40 mic.
17	Dosje me mekanizëm, 7cm	copë	Dosje me mekanizëm, material plastik, me kuti. Përmasat 28 x 35 x 7 cm (deri në 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.
18	Dosje arkive kartoni me buton 10 cm	copë	Të jetë material kartoni, të ketë kapëse (perçinë) për mbylljen e dosjes, në brendësi të ketë kapak fiksues me perçina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore, të jetë me përmasa 34 x 24 x 10 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme.
19	Kuti Arkive kartoni standard	copë	Të ketë përmasa 18 x 28.5 x 40.5 cm, material kartoni i fortë dhe i trashë, me kapak. (deri në 5% marzh gabimi).
20	Korrektor stilo blister	copë	Korrektor 7 ml (+/-1 ml). Për përdorime të ndryshme, me tharje të shpejtë.
21	Zarfa plastik A4 (100 fije/ pako) qese plastike dokumentash	pako	Pako me 100 qese plastike prej materiali polipropilen, transparente dhe me madhësi A4, me spesor jo më pak se 100 mikron. Këto qese mund të përdoren me të gjitha llojet e lidhësave të unazave si një mënyrë për të mbrojtur dhe renditur dokumentet. Çdo qese duhet të ketë kapacitet mbajtës jo më pak se 40 fletë A4 80 gm2 secila.

22	Kalkulator 12 digit	copë	Makinë llogaritëse 12 shifrore, me përmasa minimumi 208 x 163 mm (deri në 5% marzh gabimi).
23	Kalkulator 16 digit	copë	Makinë 16 digit, me memorie, me të gjitha opsionet e llogaritjes, dritare lehtësisht e lexueshme. Me përmasa 208 x 163 mm (deri në 5% marzh gabimi).
24	Blllok shënimesh, me 70 fletë	copë	Blllok shënimesh format A4. Të ketë minimumi 70 fletë, kapak kartoni, ngjyra të ndryshme, fletë me vija ose kuadrate dhe të jenë me ngjitje anësore.
25	Blllok A4 me kapak, imitacion lëkure	copë	Blllok në format A4 me kapak, imitacion lëkure. Të jetë format A4 me vija ose kuadrate, të jetë me ngjitje, me kapak imitacion lëkure, ngjyrë gri/e zezë/blu. Të ketë 100/120 fletë.
26	Blllok A5 me kapak, imitacion lëkure	copë	Blllok A5, kapak i fortë imitacion lëkure, ngjyra të ndryshme, të ketë minimumi 100 fletë.
27	Blllok shënimesh A5 me 60 fletë	copë	Blllok format A5, me letër me vija ose kuadrate, kapak i fortë kartoni me ngjyra të ndryshme, me lidhje spirale, minimumi 60 fletë.
28	Goma fshirëse	copë	Të jetë material gome. E përshtatshme për përdorime në zyrë, shkollë, etj.
29	Gërshëre zyre 17-25 cm, dorezë plastike	copë	Gërshëre me dorezë plastike, me përmasa 17-25 cm
30	Evidenciator 4 ngjyra	pako	Të jetë në 4 ngjyra të ndryshme, me maja minimumi 4.5 mm, të mos fshihet.
31	Kub plastik me letra shënimesh	copë	Kub plastik që mban letra shënimesh pa ngjitje, bashkë me letrat. Përmasa 90 x 90 x 90 (+/- 5% marzh gabimi).
32	Kub shënimesh me ngjitje	copë	Kub shënimesh me ngjitje. Të jetë me ngjitje, përmasa 75 x 75 (deri në 5% marzh gabimi) ngjyra të ndryshme, jo më pak se 400 fletë.
33	Blllok shënimesh me ngjitje, 100 fletë (letër postite) 70x100	copë	Blllok shënimesh me ngjitje, ngjyra e verdhë. Përmasa 70 x 100 mm (+/-5% marzh gabimi), jo më pak se 100 fletë.
34	Ndarëse letre me 40 fletë	copë	Ndarëse për letër, për organizim dosjesh. Gjithashtu, mund të përdoren edhe si etiketa për shënime. Materiali të jete letër e hollë, me ngjitje të lehtë që nuk dëmton dokumentat. Të jetë në përmasat 50 mm x 15 mm, me 4 ngjyra, me 40 fletë secila ngjyrë.
35	Prerëse lapsash plastike me depozitë	copë	Prerëse lapsi, forma katror dhe konike, me depozitë për mbetje, me një folë prerëse.
36	Ngjitës letre (Stik i bardhë) 21 gr	copë	Ngjitës letre, i bardhë, në formë buzëkuqi, 21 gr (+/- 1 gr). Të mos përmbajë elementë të dëmshëm, i përshtatshëm për letër.
37	Lapsa me gome HB	copë	Laps grafiti me gomë për përdorim të përgjithshëm me fortësi HB. Të jetë pako me 12 copë.

38	Vinovil minimumi 100-120 gr	shishe	Vinovil minimumi 100 - 120 gr, ngjitës i bardhë, për përdorim të gjerë, dru, tekstil, letër, karton etj. Të mos përmbajë elementë të dëmshëm.
39	Vizore 50 cm	copë	Vizore plastike 50 cm, e shkallëzuar ne milimetra dhe centimetra, material plastik i përkulshëm.
40	Ulluk plastik lidhje 3 mm	copë	Të jetë material plastik, format A4, gjerësia 3 mm, me ngjyra të ndryshme.
41	Ulluk plastik lidhje 6 mm	copë	Te jetë material plastik, format A4, gjerësia 6 mm, me ngjyra të ndryshme.
42	Ulluk plastik lidhje 8 mm	copë	Të jetë material plastik, format A4, gjerësia 8 mm, me ngjyra të ndryshme.
43	Izolant (Shirit ngjitës, letër i bardhë)	copë	Shirit ngjitës, letër e bardhe, përmasa minimumi 50 mm x 65 mm. I përshtatshëm për paketim, vulosje pakosh ose përdorime të përgjithshme në zyrë dhe magazine.
44	Stilolapsa të thjeshtë me kapak (Blu)	copë	Stilolapsa me kapak të thjeshtë, të veshur me material plastik, ngjyra e bojës të jete Blu. Bojë që nuk shpërndalet, nuk njolloset lehtësisht, e qëndrueshme në kohë.
45	Stilolapsa të thjeshtë me kapak (Zi)	copë	Stilolapsa me kapak të thjeshtë, të veshur me material plastik, ngjyra e bojës të jete Zi. Bojë që nuk shpërndalet, nuk njolloset lehtësisht, e qëndrueshme në kohë.
46	Stilolapsa të thjeshtë me kapak (Kuq)	copë	Stilolapsa me kapak të thjeshtë, të veshur me material plastik, ngjyra e bojës të jete Kuqe. Bojë që nuk shpërndalet, nuk njolloset lehtësisht, e qëndrueshme në kohë.
47	Stilolaps rapid, lantu ose ekuivalenti i tij	copë	Me majë 0.5 mm me kapëse metalike. Bojë që nuk shpërndalet, nuk njolloset lehtësisht, e qëndrueshme në kohë.
48	Stilograf	copë	Stilograf, me hapje, bojë blu, me depozitë. Bojë që nuk shpërndalet, nuk njolloset lehtësisht, e qëndrueshme në kohë.
49	Rapidograf 0.5 mm (Blu, Kuq, Zi) (12 copë/pako)	pako	Të jetë me majë 0.5 mm, me ngjyra të ndryshme, shkrimi rapid, me kapak. Te kete 12 copë/pako.
50	Stilolaps cilësor për lidhje marrëveshje	copë	Stilolaps me majë 0.7 mm. Me bojë xhel, me ngjyra të ndryshme, me kapak. Bojë që nuk shpërndalet, nuk njolloset lehtësisht, e qëndrueshme në kohë.
51	Mbajtëse kancelarish rrjete 3 vende (lapsa)	copë	Mbajtëse kancelarie që mban mjete pune, (laps, gome, vizore, gërshërë, stilolaps, thikë për prerje, kapëse aktesh etj).
52	Mbajtëse dokumentash metalike 3-she	copë	Mbajtëse dokumentash metalike 3 kate, me përmasa 36±1 cm x 28±1 cm x 30±1cm. Ajo shërben për të vendosur dokumentat e përdorimit të përditshme për zyra. të jetë e qëndrueshme dhe terësisht metalike.
53	Mbajtëse kancelarie për mjete	copë	Mbajtëse kancelarie që rrotullohet të ketë minimumi 12 mjete pune, (laps, gome, vizore, gërshërë, stilolaps, thikë për prerje, kapëse aktesh etj.)

54	Bojëra uji me 12 ngjyra me penel	pako	Bojëra uji me 12 ngjyra, me penel. Të jenë bojëra të lëngshme bazuar në ujë, pa helm dhe jo toksike. Të thahen brenda disa minutash duke ruajtur ngjyrën e gjallë. Përdoren për pikturë artistike, dekorativë dhe projektet të artit dhe dizajnit. Minimumi 12 ml tubi.
55	Lapustila me ngjyra të ndryshme (Marker permanent Kuti 4 ngjyrëshe)	pako	Marker permanent kuti 4 ngjyrëshe.
56	Kartona të bardhë	fletë	Fletë kartonit (Tabak) përmasa 50x70cm, (marzh gabimi deri në 5%). Përdoret për të bërë vizatime ose printime të ndryshme. Letër cilësore, ngjyrë e bardhë.
57	Fletore vizatimi	copë	Të jetë me kapak kartoni, me lidhje me ngjitje në anësore ose me tel, numri i fletëve të jetë minimumi 10 fletë. Ngjyra e fletës të jetë e bardhë.
58	Fletë Dizenjo për vizatim	copë	Letra të jetë cilësore jo me llustër në mënyrë që të jetë e lehtë për të vizatuar.
59	Lapsa me ngjyra vizatimi druri	pako	Lapsa me ngjyra vizatimi druri, grafiti i ngjyrosur të jetë i mbështjellë nga druri dhe i lehtë për përdorim. Të jenë të përshtatshëm për të ngjyrosur në sipërfaqe të ndryshme të letrës. Pako me minimumi 6 copë (lapsa me ngjyra të ndryshme).
60	Karton me ngjyra të ndryshme (50 cm x 70 cm)	pako	Karton në formatin e letrës A4, prej materiali letre cilësore, me përmasa 50x70 cm, në ngjyra të ndryshme. Përdoret për realizimin e punimeve të ndryshme, vizatimin apo printimin e figurave, dekorimin e ambienteve të brendshme për festa të ndryshme, paketimin e dhuratave të vogla, etj. Ky produkt është i përshtatshëm për përdorim në kopshte, shkolla, ambiente shtëpie, etj. Minimumi të përmbajë 100 fletë.
61	Portamina 0.7MM	copë	Portaminë me strukturë prej materiali plastik rezistent, me majë 0.7 mm.
62	Maja Portamine 0.5 MM	copë	Maja portamine 0.5 mm, diametri nominal i majës prej plumbi të jetë min 0.5 mm me fortësi HB.
63	Maja Portamine 0.7 MM	copë	Maja portamine 0.7 mm, diametri nominal i majës prej plumbi të jetë min 0.7 mm me fortësi HB.
64	CD -R MIN 52 X, 700 MB	kuti	CD-R minimumi 52X, 700 MB, përmasa standarde, të paketuara në kuti. Minimumi kapacitet 700 MB /80 minutash dhe shpejtësi regjistrimi minimumi 52X për regjistrim një herë. Të jetë rezistent ndaj pluhurave dhe ndaj ujit, gjithashtu duhet t'i rezistojnë ndryshimeve në temperaturë dhe lagështi. Të sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të skedarëve dhe dokumenteve të rëndësishme, ideale për të gjitha fotot dhe videot. Të paketuara në kuti me 10 copë.
65	DVD-R, 16 x 4.7GB	bobinë	Disqet optike sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të skedarëve dhe dokumenteve të rëndësishëm, ideale për të gjitha fotot dhe videot. Me shpejtësi 16x dhe kapacitet regjistrimi 4.7

			GB, deri në dy orë video në një disk DVD-R. Të jetë rezistent ndaj pluhurave dhe ndaj ujit, gjithashtu duhet t'i rezistojnë ndryshimeve në temperaturë dhe lagështi. Paketimet duhet të jenë të dobishëm dhe mbrojtëse ndaj prekjeve për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e disqeve. Të jenë në paketim bobinë me 10 copë.
66	Bateri 1.5 V të vogla AAA	copë	Bateri 1.5 V të vogla AAA, Alkaline, për përdorim në pulte kondicioneri, pulte televizori, ora etj, afat skadence minimumi 2 vjet.
67	USB 3.0, 64 GB	copë	USB me kapacitet 64GB, porta USB 3.0, sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të të dhënave.
68	USB Flash Drive 16 GB 3.0	copë	USB Flash Drive 16 GB 3.0, USB me kapacitet ruajtje 16 GB, Lloji i lidhësit: USB Type A. Prodhimi i USB-se (gjenerata): USB 3.0, Kapaciteti i ruajtjes: 16 Gigabyte, i përshtatshëm për sisteme të ndryshme operative, me përmasa dhe forma të ndryshme sipas brandeve që ekzistojnë në treg.
69	USB 3.0, 128 GB	copë	USB me kapacitet 128 GB, porta USB 3.0, sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të të dhënave. Ofron teknologji dhe shpejtësi të gjeneratës 3.0.
70	Heqëse teli pincë	copë	Të ketë formën standarde, madhësi normale. Të jetë material inoxi, të ketë formën e pincës. Të shërbeje për të hequr telat nga dokumentat pa i dëmtuar.
71	Makinë heqëse teli e vogël	copë	Heqëse teli flutur, të jetë material metalik, me veshje plastike, të ketë formën standarde, madhësi e vogël, me sustë.
72	Makina grirëse me kosh, dokumentesh të mëdha	copë	Makinë grirëse me kosh dokumentesh të mëdha. Me kapacitet grirës minimumi 10 fletë njëherësh, Të grijë CD, kartë krediti, kapëse, tela.
73	Kapshë aktesh Nr.3	kuti	Për kapje letrash, nr.3, përmasa 28 mm, metalike, të forta dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve. Kuti me 100 copë.
74	Kapshë aktesh me veshë 15 mm	kuti	Kapshë me veshë 15 mm, metalike, të forta dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur pak fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve. Kuti me 12 copë.
75	Kapshë aktesh me veshë 19 mm	kuti	Kapshë me veshë 19 mm, metalike, të forta dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve. Kuti me 12 copë.
76	Kapshë aktesh me veshë 25 mm	kuti	Kapshë me veshë 25 mm, metalike, të forta dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve. Kuti me 12 copë.
77	Kapshë aktesh me veshë 32 mm	kuti	Kapshë me veshë 32 mm, metalike, të forta dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur shumë fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve. Kuti me 12 copë.

78	Kapse aktesh me veshë 41 mm	kuti	Kapse me veshë 41 mm, metalike, të forta dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur sasi të madhe fletësh bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve. Kuti me 12 copë.
79	Kapse aktesh me veshë 51 mm	kuti	Kapse me veshë 51 mm, metalike, të forta dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur sasi të madhe fletësh bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve. Kuti me 12 copë.
80	Makinë qepje dokumentesh 23/20	copë	Makinë për qepje dokumentesh, me tela 23/20, të kapë minimumi 180 fletë. Materiali plastik + metal.
81	Makinë qepese 24/6	copë	Makinë qepëse aktesh 24/6, material metal + plastike. Të kapë minimumi 25 fletë.
82	Makinë qepëse aktesh 100 fletë	copë	Makinë qepëse aktesh, të kapë minimumi 100 fletë.
83	Makinë qepëse aktesh 220 fletë	copë	Makinë qepëse aktesh, të kapë minimumi 220 fletë.
84	Makinë kapëse minimumi 450 fletë	copë	Makinë për lidhje dokumentesh. Të shpojë 25 fletë njëherësh, të lidhë minimumi 450 fletë.
85	Tela për makina kapëse aktesh 23/6	kuti	Tela për makina kapëse aktesh 23/6. Të ketë 1000 tela.
86	Tela për makina kapëse aktesh 23/8	kuti	Tela për makina kapëse aktesh 23/8. Të ketë 1000 tela.
87	Tela për makina kapëse aktesh 23/13	kuti	Tela për makina kapëse aktesh 23/13. Të ketë 1000 tela.
88	Tela për makina kapëse aktesh 23/15	kuti	Tela për makina kapëse aktesh 23/15. Të ketë 1000 tela.
89	Tela për makina kapëse aktesh 24/6	kuti	Tela për makina kapëse aktesh 24/6. Të ketë 1000 tela.
90	Tela për makina kapëse aktesh 23/20	kuti	Tela Makinë 23/20. Të ketë 1000 tela.
91	Bojë vule blu, kuti plastike	shishe	Bojë për vulë ngjyrë blu, e përshtatshme për të gjitha llojet e vulave. Bojë ekologjikisht e pastër dhe rezistente. Boja vjen në paketim 30ml. Kuti plastike.
92	Libër poste 100 faqe model 4	copë	Libër i përshtatshëm për të dorzuar dorëzuar dokumentat në postë.
93	Regjister Korespodence (Protokolli) 100 faqe	copë	Hartuar sipas nenit 19 të “Normave Teknike Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, modeli 1 (duhet të jetë e shkruajtur në çdo fletë)
94	Libër Arke 3 kopje	copë	Libër i arkës me 3 kopje me 100 fletë
95	Libër shpërndarjesh dokumentash model 4/1	copë	Libër shpërndarjesh dokumentash model 4/1
96	Zarfa të vegjel 11x23	copë	Të jenë material letre, me përmasat 11 x 23 cm (+/- 5% marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.

97	Zarfa të mesem A4	copë	Të jenë material letre, permasat mesatare (+/- 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.
98	Zarfa 16 x 23cm	copë	Të jenë material letre, përmasat 16 x 23 cm (+/- 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë me peshë 80gr/m2.
99	Zarfa 30 x 40 cm	copë	Të jenë material letre, material cilësor, përmasat 30 x 40 cm (+/- 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje.
100	Zarfa 30 x 44 cm	copë	Të jenë material letre, material cilësor, përmasat 30 x 44 cm (+/- 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje.
101	Zarfa 44 x 36 cm	copë	Të jenë material letre, përmasat 44 x 36 cm (+/- 5% marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.
102	Zarfa 19 x 26 cm	copë	Të jenë material prej letre, me përmasat 19 x 26 cm (+/- 5% marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.
103	Zarfa 23 x 33 cm (A4)	copë	Të jenë material prej letre. Përmasat 23 x 33 cm (+/- 5% marzh gabimi) me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.
104	Zarfa 26 x 36 cm	copë	Të jenë material letre, permasat 26 x 36 cm (+/- 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë.
105	Zarfa të mëdhenj A4	copë	Të jenë material letre, të mëdhenj (+/- 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë
106	Zarfa A3	copë	Të jenë material letre, permasa A3 (+/- 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë
107	Axhendë ditore afërsisht 14.2 x 20.5 cm pa logo	copë	Axhenda ditore të ketë përmasat 14.2 x 20.5 cm (deri në 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme, minimumi të ketë 300 fletë, të shkruhet viti aktual.
108	Dosje konference me kapse të fortë pa logo	copë	Dosje konference me kapse të fortë. Format A4. E lehtë për t'u transportuar, përdoret për mbajtjen e materialeve të leksioneve apo fjalimeve të konferencave.
109	Kalendar tavoline	copë	Kalendar tavoline 2026 me kapak të fortë të papërthyeshem me lidhje me spirale, me përmasa 29.8x10.5cm, (marzh gabimi deri në 5%), minimumi 55 fletë, 1 fletë të ketë një javë.
110	Marker për CD e zezë ose color	copë	Marker për CD e zezë ose ngjyra të ndryshme, me 2 anë 0.5-1 mm.
111	Axhendë e vogël A6 (xhepi)	copë	Axhendë e vogël A6 (xhepi): madhësia A6, me fletë me vija ose kuadrate, me kapak kartoni, të shkruhet viti 2026.
112	Blllok shënimesh me material adesiv 75 x 75 mm	copë	Blllok shënimesh, me material adesiv (me ngjitje), përmasa 75 x 75 mm, me 100 fletë (deri në 5% marzh gabimi).
113	Mbajtëse plastike dokumentesh horizontale	copë	Të jetë material plastik me ngjyra të ndryshme. Të shërbejë për të vendosur dokumentat e përdorimit të përditshëm dhe të jetë e përshtatshme për zyra.
114	Mbajtëse dokumentesh 4 sirtarë me çelës	copë	Mbajtëse dokumentesh 4 sirtarë me çelës. Për mbajtje dokumentesh format A4.

115	Sfungjer për lagie gishti 8 cm	copë	Sfungjer për lagie gishti, 8 cm.
116	Mbajtëse Nadirbandi standard	copë	Mbajtëse 9 x 4.5 x 4 cm, për nadirban 18x18 mm. (marzh gabimi deri ne 5%).
117	Tampon vule i mesem	copë	Ngjyra blu të jetë në kuti metalike, përmasa minimumi 8 x 12 cm.
118	Kapak transparent për lidhje A4	fije	Formati A4, i tejdukshëm. Kapaku të ketë trashësinë minimumi 150 mic.
119	Flete Hyrje 3 kopje nga 30 fletë	blloqe	Blllok Fletë-Hyrje, me 3 kopje, ngjyra të ndryshme. Duhet të ketë 30 fletë.
120	Flete Dalje 3 kopje nga 30 fletë	blloqe	Blllok Fletë-Hyrje, me 3 kopje, ngjyra të ndryshme. Duhet të ketë 30 fletë.
121	Urdhër Dorzimi 2 kopje	blloqe	Blllok dorzimi të jetë në dy kopje.
122	Bexho PVC me clip metalik	copë	Bexho PVC me kapëse metalike. Materiali i bexhos të jetë plastik i fortë.
123	Kordon për bexho	copë	Material prej cope, me kapëse metalike. Gjerësia e kordonit minimumi 1.5 cm.
124	Etiketa adezive të mëdha	kuti	Etiketa adezivite të mëdha, në kuti, kutia me 100 fletë A4.
125	Thika të mesme	copë	Thikë e mesme, të jetë me prerëse të lëvizshme, me shinë me fiksues, material plastik nga jashtë, të jetë e mprehtë për përdorim për prerje kartoni, fletët transparente etj.
126	Shkumësa me ngjyra	copë	Shkumësa me ngjyra. Shumësat janë të përshtatshme për shënime në tabela, në tekstil
127	CD-R min 40x90 800 MB, me kapak	copë	CD-R 800 MB, përmasa standard, çdo CD me kapak. Minimumi kapacitet 800MB/90 minutash dhe shpejtësi regjistrimi deri në 40X për regjistrim. Të sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të skedarëve dhe dokumenteve të rëndësishëm ideale për të gjitha fotot dhe videot.
128	Ngjyra Uji	pako	Ngjyra uji set me 12 marker shumë ngjyrësh me bazë uji. Të pademshëm e të përshtatshëm për fëmijë.
129	Letra laminuese A4	pako	Letra laminuese" i referohet një letre dekorative, shpesh një letre të laminuar me melaminë, që përdoret për dekorimin e sipërfaqeve në dizajnin e brendshëm dhe të jashtëm, ose një laminati ose filmi të përdorur në një makinë laminimi për të mbrojtur dhe përmirësuar dokumentet.
130	Penela per bojra akwareli	seri	Penelat për bojra akwareli duhet të kenë qime natyrale ose sintetike që mbajnë mirë ujin dhe të kenë formë të përshtatshme si round, flat apo mop për teknika të ndryshme. Preferohen doreza druri dhe ferri metalik inox për qëndrueshmëri dhe kontroll të mirë gjatë pikturimit.
131	Bojra akrilike 12 ngjyra	pako	Bojrat akrilike me 12 ngjyra janë bojra me bazë uji që thahen shpejt dhe krijojnë një shtresë të qëndrueshme dhe rezistente ndaj ujit pas tharjes. Seti përfshin ngjyra bazë të përziera mirë,

			të përshtatshme për pikturë në kanavacë, letër, dru apo sipërfaqe të tjera.
132	Bojëra vaji për pikturë	pako	Bojëra vaji me 12 ngjyra, Minimumi 12ml/tubi. Përbërja: bojëra me bazë vajore, pa toksina. Përdoren me brushë, spatula dhe mjete të tjera artistike, nuk çahen ose zbehen lehtë pas tharjes.
133	Penela për bojëra vaji	seri	Penelat për bojëra vaji kanë qime më të forta (natyrale ose sintetike), të dizajnuara për të përballuar trashësinë dhe strukturën e bojës së vajit. Ato vijjnë në forma të ndryshme si filbert, flat, apo bright, që ofrojnë kontroll më të madh në përhapjen e bojës në kanavacë.
134	Bojra Uji	pako	Bojëra uji me 12 ngjyra, me penel. Të jenë bojëra të lëngshme bazuar në ujë, pa helm dhe jo toksike. Të thahen brenda disa minutash duke ruajtur ngjyrën e gjallë. Përdoren për pikturë artistike, dekorativë dhe projektet të artit dhe dizajnit. Minimumi 12 ml tubi.
135	Lapustila për dërrasë	pako	Lapustilat për dërrasë të bardhë (ëhiteboard markers) janë shkruar me bojë jo-permanente që fshihen lehtësisht. Të jenë për të shkruar në dërrasa të bardha dhe sipërfaqe të lëmuara, duke ofruar shkrim të pastër.
136	Letër shumëngjyreshe me xixa	pako	Letër me përmasa a4 me shkëlqim e me ngjyra të ndryshme. Të jenë të lehta për tu prerë dhe të palosen lehtësisht. Minimumi pakoja të përmbajë 10 copë.

***Shënim:** Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet *“markë”* pranohet termi *“ose ekuivalent i tij/i saj”*.

***Shënim:** Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 *“Specifikimet teknike”* të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 *“Kërkesat e cilësisë”* të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e

preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalentii tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

GRAFIKU I LËVRIMIT TË MALLIT

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1.	“Blerje artikuj kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë”	1,517,358.56 (një milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë e pesëdhjetë e gjashtë të qindat) lekë pa Tvsh	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	30 (tridhjetë) ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës

Afatet e lëvrimit: Afati i dorëzimit të mallit është brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i nënshkrimit të kontratës.